




REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedia. Org. Lnie	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	365
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	01	Data Datum Date	05.07.2019
Prishtinë / a			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademiya Pravde/Academy of Justice*

Nr. 01/365/2019

Datë: 05/07/2019

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 10 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e tetëmbëdhjetë të përbërjes së parë të mbajtur më 05 korrik 2019, merr këtë:

## V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja Nr. 01/2019 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Aleksandër Lumezi

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

U.D. Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë  
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në pajtim me nenin 10, paragrafit 1, nën paragrafi 1.1 e 1.9 dhe nenit 23 i Ligjit Nr.05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur me datë 05.07.2019,

Miraton:

**RREGULLORE NR. 01/2019**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR.01/2018 PËR  
ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË  
PUNËS NË AKADEMINË E DREJTËSISË**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores Nr.01/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë

**Neni 2**

Neni 16 i Rregullores Nr.01/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë (në tekstin e mëtejme: Rregullorja), riformulohet me tekstin si në vijim:

**“Neni 16**  
**Zyrtar për zhvillim dhe bashkëpunim**

1. Zyrtari për zhvillim për bashkëpunim i raporton Drejtorit të Zyrës për Trajnimit, dhe ka detyrat dhe përgjegjësit si në vijim:
  - 1.1 Bën hulumtime dhe zhvillon programe për trajnimet e trajnuesve varësisht nga programet dhe nevojat për trajnime;
  - 1.2 Organizon dhe përcjellë tek Drejtori i Zyrës së Programeve Trajnuese dhe Udhëheqësit e Programit efektet e trajnimeve për trajnues;
  - 1.3 Mban evidenca për performancën e trajnuesve dhe propozon programe adekuate trajnimi për fusha specifike dhe kategori të caktuara të trajnuesve;
  - 1.4 Është përgjegjës për organizimin e kurseve trajnuese nga distanca (e-learning);

1.5 Propozon kurse trajnuese nga distanca dhe trajnues përkatës për secilin kurs trajnues bazuar në Planin dhe Programin trajnues të AD-së;

1.6 Mbështet Drejtorin e Zyrës për Trajnime në zhvillimin e bashkëpunimit me donatorë në zhvillimin e projekteve të përbashkëta;

1.7 Përgatit raportet e aktiviteteve të AD-së që kanë të bëjnë me zbatimin e strategjive dhe programeve për integritet Evropian;

1.8 Kryen detyra tjera të parashtruara nga mbikëqyrësi”

### **Neni 3**

1. Emërtimi i nenit 17 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim

“Departamenti për trajnimin fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit”.

2. Neni 17 paragrafi 1 të Rregullores pas fjalës “Trajnimeve” shtohet fjala “Fillestare”, dhe pas fjalës” prokurorë”, shtohet fjala “të shtetit”.

3. Neni 17 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 i Rregullores fshihet.

4. Neni 17 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 i Rregullores fshihet.

### **Neni 4**

1. Emërtimi i nenit 18 të Rregullores riformulohet me tekstin si në vijim:

“Detyrat dhe përgjegjësit e Departamentit për trajnimin fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit”.

2. Neni 18 paragrafi 1 i Rregullores, pas fjalës”fillestar”, fshihet fjala ” dhe të vazhdueshëm”.

3. Neni 18 paragrafi 1 në nënparagrafin 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Rregullores pas fjalës “ trajnime ” shtohet fjala “fillestare”.

### **Neni 5**

1. Emërtimi i nenit 19 të Rregullores riformulohet me tekstin si në vijim:

“Udhëheqës i Departamentit të trajnimeve fillestare për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit”.

2. Neni 19 paragrafi 2 në nënparagrafin 2.1, 2.3, 2.4 dhe 2.5. të Rregullores pas fjalës “ trajnime” shtohet fjala “ fillestare”.

## **Neni 6**

Neni 21 i Rregullores bazë fshihet.

## **Neni 7**

1. Emërtimi i nenit 22 të Rregullores riformulohet me tekstin si në vijim:

“Departamenti për trajnime të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, avokat shtetëror, avokat dhe profesioneve tjera të lira”.

2. Neni 22 paragrafi 1 i Rregullores pas fjalës “ Departamentit” shtohen fjalët “për trajnime të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë”.

3. Neni 22 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 i Rregullores riformulohet si në vijim:

“1.2. Zyrtar i Lartë për Trajnime të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, avokat shtetëror, avokat dhe profesioneve tjera të lira”;

4. Neni 22 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe 1.4 i Rregullores fshihen.

## **Neni 8**

1.Emërtimi i nenit 23 të Rregullores riformulohet me tekstin si në vijim:

“ Detyra dhe përgjegjësi e Departamentit për trajnime të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, avokat shtetëror, avokat dhe profesioneve tjera të lira”.

2. Neni 23 paragrafi 1 i Rregullores pas fjalës “trajnimeve” i shtohet fjala “të vazhdueshëm për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit”.

3. Neni 23 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe 1.3. të Rregullores pas fjalës “ trajnime” i shtohet fjala “ për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit”.

4. Neni 23 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 i Rregullores pas fjalës “programit” i shtohet fjala “për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit”;

5. Neni 23 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 i Rregullores pas fjalës “raportimi” i shtohet fjala “për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit”.

## **Neni 9**

1. Emërtimi i nenit 24 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:

“Udhëheqësi i Departamentit për trajnime të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial avokat shtetëror, avokat dhe profesioneve tjera të lira”;

2. Neni 24 paragrafi 2 në nënparagrafin 2.1, 2.3, 2.4 dhe 2.5 të Rregullores pas fjalës “trajnime” shtohet fjala “ të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit”.

## **Neni 10**

1. Emërtimi i nenit 25 të Rregullores riformulohet me tekstin si në vijim:

“ Zyrtar i lartë për trajnime të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, avokat shtetëror, avokat dhe profesioneve tjera të lira”.

2. Neni 25 paragrafi 1 i Rregullores, pas fjalës “trajnim” shtohen fjalët ” e vazhdueshëm për gjyqtarë dhe prokurorë”.

## **Neni 11**

Neni 39 i Rregullores riformulohet me tekstin si në vijim:

### **“Neni 39 Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore**

1. Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore për punën e tij i raporton Drejtorit të Departamentit për Administratë dhe Financa dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi:

1.1 Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre;

1.2 Analizon dhe vlerëson planin rrjedhës të parasë dhe siguron se shpenzimet janë bërë në pajtim me procedurat dhe standardet për buxhet dhe financa;

1.3 Siguron që mjetet buxhetore janë në dispozicion për shpenzim dhe janë bërë zotimet përkatëse në sistemet përkatëse të institucioneve financiare dhe buxhetore;

1.4 Rishikon çdo urdhër zotimi dhe pagese si dhe dokumentet përkatëse për iniciimin e procedurave për prokurim dhe i përcjell për veprim të mëtutjeshme;

1.5 Regjistron të gjitha zotimet e shpenzimeve në sistemin e menaxhimit të financave dhe kontrollit sipas llojeve të shpenzimeve dhe i përcjell deri në realizimin e shpenzimeve;

1.6 Barazon raportet e shpenzimeve me sistemin e thesarit në bazë tre mujore gjashtë mujor dhe vjetore dhe bashkëpunon me strukturat tjera organizative të ministrisë lidhur me zotimet dhe shpenzimet;

1.7 Mbikëqyr dhe zbaton kontrollin efektiv të menaxhimit të parave të gatshme dhe mirëmban dokumentacionin financiar dhe dosjet për te gjitha pagesat;

1.8 Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi”.

## Neni 12

Organogrami i Akademisë së Drejtësisë që pasqyron ndryshim plotësimet në strukturën dhe organizimin e vendeve të punës së Akademisë është pjesë e kësaj Rregulloreje.


## Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë.

Prishtinë, 05.07.2019

Aleksandër Lumezi  
*A. Lumezi*  
Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë



## Shtojcë –Organogrami

